

OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
DEPARTAMENTI I FINANCËS
DREJTORIA EKONOMIKE

Nr. 6004/.....Prot
2

Tiranë, më 07/10/2024

Lënda: Përgjigje shkresës Nr.1859/2, datë 20.09.2024 "Kërkesë për informacion në lidhje me Aplikimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën rregullatore 2025-2027"

ENTIT RREGULLATOR TË ENERGJISË
Adresa: Blvd. Bajram Curri, Rr. Viktor Efremiu 1023

I nderuar Z. Ahmeti,

Në përgjigje të shkresës suaj Nr.1859/2, datë 20.09.2024 "Kërkesë për informacion në lidhje me Aplikimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën rregullatore 2025-2027", mbërritur në OST me datë 24.09.2024, lutem gjeni informacionin e kërkuar si më poshtë vijon:

1. Paraqitjen në formë analitike të çdo zëri të të ardhurave dhe shpenzimeve faktike të muajve janar-gusht të vitit 2024 si dhe parashikimet e kryera për periudhën e mbetur të vitit 2024 dhe periudhën 2025-2027. Këto të dhëna duhet të jenë të shoqëruara me arsyetimet, argumentet si dhe dokumentet justifikuese (dokumentacion i cili mund të përcillet i skanuar)
- Sqarimi:** Në tabelën e mëposhtme jepen zërat e detajuar të realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën Janar-Gusht 2024 si dhe parashikimet për periudhën e mbetur të vitit 2024 dhe 2025-2027;

VLERESIME 2023-2027 TREGUESIT KRYESORE		Viti 2023	Viti 2024		2025	2026	2027
Emertimi	Njesia Matese		8 Mujori Fakt	1 Pritshmi			
Energjia Totale që hyn në sistemin e OST	GWh	10,147	6,737	11,571	10,553	10,684	10,833
Prodhim vendas	"	8,226	5,061	8,191	8,136	8,388	8,539
Energji në marrje	"	1,922	1,676	3,380	2,417	2,296	2,294
Energjia totale e transmetuar	GWh	9,927	6,600	10,081	10,325	10,450	10,585
Energji elektrike e dhënë	"	2,842	1,644	2,658	2,924	3,070	3,224
Energji elektrike për OSHEE sh.a.	"	6,492	4,555	6,788	6,734	6,680	6,627
Energji elektrike për konsumatorët e kualifikuar	"	594	401	635	666	700	735
Humbjet në rrjetin e transmetimit	GWh						
Humbjet në GWh	"	220	137	1,489	228	234	247
Humbjet në %	%	2.17%	2.03%	12.87%	2.16%	2.19%	2.28%
Investimet gjithsej	Mln/Lekë	3,435	3,188	7,664	8,629	3,887	3,513
Nga këto:							
Sipas burimeve të financimit	Mln/Lekë						
Burimet e veta	"	2,041	1,370	3,641	4,325	3,887	3,513
Ndihmë dhe kredi e huaj	"	1,393	1,818	4,023	4,304	0	0
Buxheti i shtetit	"						
Treguesit e punës							
Punonjës gjithsej	Nr.mesatar	756	745	792	817	817	817
Fondi i pagave gjithsej	Mln/Lekë	741	548	859	893	920	947
Paga mesatare	Lekë	81,707	91,995	90,349	91,088	93,821	96,635
Sasia e transmetuar (OSHEE+FurnizuesKualifuar)	GWh	7,086	4,956	7,423	7,401	7,380	7,362

TE ARDHURAT							
Transmetimi i energjië	mln Leke	6,044	4,256	6,405	6,291	8,291	8,271
Alokimi i kapaciteteve	mln Leke	2,508	1,109	2,106	1,660	1,760	1,800
Të ardhura nga telekomunikacioni	mln Leke	40	8	35	70	70	80
Disbalancat	mln Leke	1,313	900	900	0	0	0
Te Ardhura te Tjera	mln Leke	5,371	936	851	25	30	35
Te Ardhura nga grantet	mln Leke	96	63	73	50	75	80
Totali te Ardhura	mln Leke	15,372	7,272	10,370	8,096	10,226	10,266
SHPENZIMET							
Blerja e humbjeve	mln Leke	2,124	1,166	1,940	2,549	2,366	2,222
Blerja e shërbimeve ndihmese	mln Leke	806	277	1,101	1,759	1,947	2,377
Menaxhimi i kongjestionit me rdispecim	mln Leke			0			
Pagesë ITC	mln Leke	378	189	314	300	300	300
Materiale të para	mln Leke	103	49	119	167	169	171
Personeli	mln Leke	1,201	922	1,519	1,690	1,736	1,784
Furnitoret dhe Shërbimet (Te tjere)	mln Leke	1,086	481	764	820	836	853
Amortizimi	mln Leke	2,563	1,513	2,534	2,610	2,688	2,769
Totali i Shpenzimeve Operative	mln Leke	8,261	4,597	8,290	9,894	10,043	10,476
Interesa	mln Leke	889	335	489	349	331	312
Fitimi/Humbja para tatimeve	mln Leke	6,222	2,340	1,591	-2,147	-147	-523
Tatim Fitimi	mln Leke	652	358	279	0	0	0
Fitimi/Humbja Neto	mln Leke	5,570	1,982	1,312	-2,147	-147	-523

Për sa i përket kërkesave tuaja që këto të dhëna duhet të jenë të shoqëruara me arsyetimet, argumentet si dhe dokumentet justifikuese (dokumentacion i cili mund të përcillet i skanuar), do të kërkonim mirëkuptimin tuaj në përcaktimin konkret të dokumentacionit të kërkuar.

Në gjykimin tonë, përzgjedhja dhe monitorimi në vend i tyre nga ana e ERE mund të ishte më efikas në kohë.

Një gjykim i tillë, qëndron për të gjithë rastet ku përmendet termi “Gjithë dokumentacionin dhe informacionin mbështetës”..

- Referuar kostove operative të paraqitura, evidentohet se realizimi i zërit "shpenzime personeli" për periudhën janar qershor 2024 është në vlerën 680 milionë lekë me një numër mesatar të punësuarish prej 752 personash, ndërkohë që për gjashtë - mujorin e dytë shoqëria parashikon që ky shpenzim të jetë në vlerën 839 milionë lekë dhe 756 të punësuar. Megjithatë parashikimi i gjashtë mujorit të dytë të këtij shpenzimi për vitin 2024 është rreth 23 përqind më i lartë se sa kostot faktike të gjashtë mujorit të parë, kërkojmë arsyetimet/argumentet Tuaja mbi këtë rritje të planifikuar. Më tej, referuar parashikimit për vitin 2025, zëri "shpenzime personeli" përllogaritet në vlerën 1,689 milionë lekë dhe një numër mesatar të punësuarish prej 817 personash. Krahësohet me vitin 2024 ky shpenzim dhe personelit për vitin 2025 parashikohen me një rritje të konsiderueshme, për të cilën duhen të paraqisni gjithashtu argumentet Tuaja.

Për qëllime të vlerësimit të këtij zëri kërkojmë të përcillni në ERE organigramën e plotë të shoqërisë dhe borderonë e pagave të muajit gusht 2024, në të cilën të jenë të evidentuara qartë niveli i pagave, trajtimet financiare si dhe çdo zë tjetër komponent përbërës i shpenzimeve të personelit. Këto të dhëna duhet të jenë të ndara sipas secilës kategori punonjësisht si për aktivitetin e rregulluar ashtu edhe për aktivitetet e tjera të shoqërisë.

Sqarimi: Për sa i përket shpenzimeve të personelit, ju bëjmë me dije se me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës së Ost sh.a. Nr. 3, datë 16.05.2024 “Për disa ndryshime në strukturën

e pagave të OST sh.a.”, janë miratuar disa ndryshime në pagat dhe trajtimet e personelit të OST sh.a. të cilat konsistojnë në:

- Rritjen e pagës baze të punonjësve duke filluar nga data 1 maj 2024, sipas qasjes:
 - ✓ Rritja në masën 25% të gjithë kategorive të pagave të punonjësve;
 - ✓ Rritja në masën 30% i kategorive të pagave për disa nga pozicionet e punës të cilat konsiderohen si kritike;
- Ndryshimin e masës së shpërblimit në formën e pagës në natyrë në vlerën 750 lekë/ditë pune;
- Ineksimin vjetor të pagave me normën e publikuar të inflacionit, duke filluar nga data 1 Janar 2025.

Gjithashtu, me shkresën Nr. 10027/1 datë 05.08.2024 të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit “Miratimi i ndryshimeve në programin e Zhvillimit Ekonomik të Ost sh.a., është miratuar shtimi i numrit të punonjësve për vënien në punë dhe operimin e Nënstacionit të ri, Hoxharë, pjesë e Sektorit të Shfrytëzimit në Njësinë Operative Fier (NJO-F), me një shtim me 11 punonjës, sipas Vendimit Nr. 8, datë 18.07.2024 të Këshillit Mbikëqyrës së OST sh.a..

Efektet e hyrjes në fuqi nga data 1 Maj 2024 të strukturës së re të pagave të OST sh.a., pasqyrojnë dhe ndryshimin e kostove të personelit për periudhën e mbetur të vitit 2024.

Për sa i përket kostove të personelit të parashikuara për vitet 2024-2027, vlerësimi i tyre është bërë duke reflektuar indeksimin e pagave me normën 3%, në zbatim të Vendimit të Këshillit Mbikëqyrës Nr. 3, datë 16.05.2024.

Tabelat e mëposhtme pasqyrojnë në mënyrë analitike zërat e kostove të personelit për periudhën Janar-Gusht 2024 si dhe parashikimet për periudhën e mbetur të vitit 2024 dhe 2025-2027

Llogaria	Realizimi i Shpenzimeve per paga sipas Njësive Janar-Gusht								
	NJMT	NJO-Tirana	NJO-Elbasan	NJO-Fier	NJO-Korce	NJO-Burrel	NJO-Shkoder	Aparati Qendror	Kosto total
Fond per Pagat	30,658,806	64,496,283	37,788,906	58,558,785	28,428,683	37,090,480	63,787,682	227,478,286	548,287,911
Shtesa turni & Ore jashte orarit	1,478,042	8,355,441	4,567,918	6,848,045	2,525,236	4,495,116	6,204,514	5,083,732	39,558,044
Ushqim Ditor	4,222,750	9,232,400	5,726,500	9,045,250	4,071,500	5,957,000	10,458,750	20,936,694	69,650,844
Udhetim dhe Dieta	548,500	-	-	264,000	244,000	612,500	1,985,000	5,308,952	8,962,952
Sigurime Shoqerore	6,662,505	14,843,566	8,723,227	11,595,196	6,343,563	8,592,799	14,559,332	43,706,993	115,027,181
Vjetersia ne Pune	3,646,666	7,308,168	4,399,868	6,647,580	3,146,800	4,123,143	6,979,258	22,574,746	58,826,229
Pensioni Vullnetar	1,274,980	3,963,260	2,418,180	5,820,809	2,303,640	2,956,380	1,828,860	16,092,058	36,658,167
Shpenzime te tjera Personeli	37,500	6,398,523	4,184,667	6,638,131	3,074,000	3,617,000	7,435,428	13,829,263	45,214,512
Kosto Totale Personelit	48,529,749	114,597,641	67,809,266	105,417,796	50,137,422	67,444,418	113,238,824	355,010,724	922,185,840

Parashikimet për periudhën e mbetur të vitit 2024 dhe 2025-2027

Llogaria	Parashikim 2024-2027			
	I pritshmi 2024	2025	2026	2027
Fond per Pagat	858,679,825	893,027,018	919,817,829	947,412,363
Shtesa turni & Ore jashte orarit	65,474,605	65,794,717	67,768,559	69,801,616
Ushqim Ditor	113,960,443	141,545,250	141,545,250	141,545,250
Udhetim dhe Dieta	19,637,464	32,960,000	33,948,800	34,967,264
Sigurime Shoqerore	216,000,000	212,153,006	218,517,597	225,073,125

Vjetërsia në Pune	91,000,000	100,000,000	103,000,000	106,090,000
Pensioni Vullnetar	55,143,687	133,954,053	137,972,674	142,111,855
Shpenzime të tjera Personeli	99,508,813	110,327,507	113,637,332	117,046,452
Kosto Totale Personelit	1,519,404,837	1,689,761,552	1,736,208,041	1,784,047,924

Gjithashtu lidhur me këtë çështje organigramën e plotë të shoqërisë dhe borderonë e pagave të muajit gusht 2024 e gjeni bashkëlidhur dhe pjesë e këtij materiali

3. Në lidhje me zërin "shpenzime administrative e të tjera" kërkohet paraqitja në formë analitike e kostove faktike të çdo zëri komponent përbërës i këtij grup - shpenzimi për vitin 2023 dhe periudhën janar - gusht 2024 si dhe parashikimet e kryera për periudhën e mbetur të vitit 2024 dhe periudhën 2025 - 2027, të shoqëruara me dokumente justifikuese dhe argumentet përkatëse.

Sqarimi: Në tabelën e mëposhtme jepen zërat e detajuar të realizimit të "shpenzime administrative e të tjera" për periudhën Janar-Gusht 2024:

Nr	Shërbime administrative e të tjera	2023	8 muji 2024	I pritshmi 2024	2025	2026	2027
1	Organizma Rajonale	87,875,506	76,996,271	138,813,209	131,000,000	137,550,000	144,427,500
2	Mirembajtje platforma, sisteme SOFTWARE, cyber, Europa kontinentale	348,621,329	107,089,376	194,931,773	189,392,000	198,861,600	208,804,680
3	Ruajtje Objekte	166,232,680	117,232,429	175,848,644	179,826,113	188,817,419	198,258,290
4	Mirembajtja e automjeteve	23,035,746	14,607,515	24,911,273	30,000,000	30,000,000	30,000,000
5	Automjete me qera	3,853,538	15,058,474	22,587,711	18,660,000	18,660,000	18,660,000
6	Sigurime	15,958,159	2,403,426	15,605,139	17,400,000	17,400,000	17,400,000
7	Mirembajtje ambjentesh	12,608,891	15,204,917	22,807,376	30,000,000	30,000,000	30,000,000
8	Kerkime studime	44,511,564	2,968,894	4,453,341	50,000,000	10,404,000	10,612,080
9	Eksperte Kontabel dhe Vleresues	61,690,000	17,706,000	25,156,000	30,000,000	30,000,000	30,000,000
10	Sherbim Teknik me jashte, aplikime, pjesmarje	3,968,415	2,355,390	3,533,085	10,000,000	12,000,000	12,000,000
11	ERE	27,304,866	31,779,172	31,779,172	25,000,000	26,250,000	27,562,500
12	Kompesimi i disbalancave në rast të ndërprerjeve të energjisë në rrjetin e transmetimit si pasojë e avarive në sisteme*				23,740,200	23,966,667	23,550,000
13	Sherbime mirembajtje dhe sherbime te tjera te telekomunikacionit	3,901,553	436,667	4,851,666.69	32,630,000	28,433,333	28,433,333
14	Shpenzime për prijje dhe përfaqësime	943,694	1,021,358	1,532,037	5,000,000	5,000,000	5,000,000
15	Trainime personeli	30,722,695	24,581,250	36,871,875	20,000,000	20,000,000	20,000,000
16	Keshilli Mbikqyres	3,770,730	2,772,491	4,158,737	4,173,600	4,298,808	4,427,772
17	Shpenzime për shërbimet bankare	1,638,930	1,284,360	1,926,539	2,500,000	2,500,000	2,500,000
18	Publicitet, reklama	276,869	122,000	183,000	1,400,000	1,500,000	1,500,000
19	Taksa, tatime dhe tarifa të tjera	9,426,713	3,234,587	8,024,379	15,000,000	15,000,000	15,000,000
20	Te tjera	239,330,752	44,546,275	45,803,333	4,000,000	35,000,000	25,000,000
Totali Shërbimet administrative e të tjera		1,085,672,629	481,400,853	763,778,290	819,721,913	835,641,827	853,136,155

4. Për zërin "materiale të para" konstatohet se kostot faktike të gjashtë mujeve të parë të vitit 2024 janë 36 milionë lekë, ndërkohë që parashikimi për gjashtë mujeve të dytë është përllogaritur në vlerën 82 milionë lekë. Po kështu, referuar parashikimeve të këtij shpenzimi për periudhën 2025 -2027, rezultojnë me një rritje të konsiderueshme krahasuar me vlerat

historike të realizimit të këtij zëri. Sa më sipër, kërkohet paraqitja në formë analitike e kostove faktike të çdo grup-shpenzimi të muajve janar - gusht të vitit 2024 si dhe të parashikimeve për periudhën e mbetur të vitit 2024 si dhe të viteve 2025 - 2027. Bashkëlidhur këtyre të dhënave duhet të përfshini gjithashtu dokumentacionin justifikues përkatës..

Sqarimi: Tabelat e mëposhtme pasqyrojnë në mënyrë analitike zërat e kostove për materialet e para për periudhën Janar-Gusht 2024 si dhe parashikimet për periudhën e mbetur të vitit 2024 dhe 2025-2027

N r.	Emërtimi	Realizimi i Shpenzimeve Materiale sipas Njësive Janar-Gusht								
		Aparati Qëndror	NJMT	Njësia Operative Shkodër	Njësia Operative Burrel	Njësia Operative Tiranë	Njësia Operative Elbasan	Njësia Operative Fier	Njësia Operative Korçë	Total 8 mujori 2024
1	Blerje Lende djegese	7,292,296	2,369,869	3,194,384	3,531,834	1,511,008	1,696,240	2,940,583	2,529,251	25,065,465
2	Blerje Materiale te tjera	4,572,323	972,253	1,935,413	2,408,533	3,348,757	921,346	6,291,843	3,032,916	23,483,384
Totali		11,864,619	3,342,122	5,129,797	5,940,367	4,859,765	2,617,586	9,232,426	5,562,167	48,548,849

Parashikimet për periudhën e mbetur të vitit 2024 dhe 2025-2027

Nr.	Emërtimi	Parashikim 2024-2027			
		1 prillshmi 2024	2025	2026	2027
1	Blerje Lende djegese	50,000,000	50,000,000	50,000,000	50,000,000
2	Blerje Materiale te tjera	68,512,373	116,577,000	118,848,540	121,165,511
Totali i Shpenzimeve Materiale		118,512,373	166,577,000	168,848,540	171,165,511

Lidhur me parashimin në rritje të zërit të shpenzimeve për materialet e para, janë bërë vlerësimet duke marrë në konsideratë ecurinë e deritanishme si dhe kontratat e reja të cilat OST sh.a. ka parashikuar të realizojë gjatë vitit 2025.


- Referuar të dhënave historike të përcjella nga ana Juaj, rezultojnë se përqindja e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit për periudhën 2022 - 2024 është në total 634 GWh, ndërkohë që parashikimi i kryer për periudhën 2025 - 2027 rezultojnë në rritje 709 GWh. Sa më lartë, duhet të rikonsiderohen parashikimet Tuaja në lidhje me kostot e blerjes së humbjeve për periudhën e mbetur të vitit 2024 si dhe referencat mbi të cilat janë mbështetur parashikimet e kryera për periudhën 2025 - 2027.

Sqarimi: Humbjet e energjisë elektrike në rrjetin transmetimit janë humbje teknike të cilat vijnë si pasojë e humbjeve të fuqisë në elementet e sistemit të transmetimit si linja, transformatorë etj. Referuar vlerave të humbjeve, ekziston një lidhje shumë e fortë ndërmjet prodhimit të energjisë elektrike në Sistemin e Transmetimit dhe humbjeve. Lidhja e drejte diktohet nga vetë konfigurimi i rrjetit të transmetimit, i cili ka një profil gjatësor, ku burimet kryesore të energjisë elektrike janë të lidhura në rrjetin 220kV, si Kaskada e Drinit, ndërsa qendrat e ngarkesës janë në Qendër dhe në Jug.

Rritja e humbjeve si pasojë e prodhimit vërtetohet akoma më shumë në rastet e eksportit, pra kur ka prodhim të lartë të energjisë elektrike në të gjithë hidrocentralet, përfshirë dhe rrjetin 110kV i cili përbën gati 35% të prodhimit të vendit në periudhat me prurje të larta. Në rastet e eksportit, rrjeti i transmetimit gjendet në kushtet e ngarkimit të lartë, në të gjithë nivelet e tensionit, duke filluar me linjat 110kV dhe 220kV të cilat diktojnë dhe vlerat e larta të humbjeve.

Grafiku në vijim, paraqet një informacion të prodhimit dhe sasisë së humbjeve në sistemin e transmetimit ndër vite:

Lidhja mes Gjenerimit dhe Humbjeve (GWh)



Sikurse konstatohet lehtësisht nga tabela e mësipërme, rritja e prodhimit të energjisë elektrike, shoqërohet me rritjen e humbjeve në sistemin e transmetimit dhe anasjelltas.

E njëjta logjikë është ndjekur edhe në parashikimin e humbjeve për periudhën 2025 – 2027 (duke marrë në konsideratë prodhimin e energjisë).

Referuar relacionit të përcjellë, parashikimet e kostove të humbjeve për vitin 2024, 2025-2027 janë kryer duke marrë në konsideratë sasinë e parashikuar të humbjeve, si dhe parashikimet e çmimeve të pritshme. Për parashikimin e çmimeve si referencë janë marrë disa tregje si HUPX, HUDEX, HENEX, SEEPX, IBEX, ALPEX, duke analizuar trendin e çmimeve. Referuar rishikimit të kostove për periudhën e mbetur të vitit 2024 (shtator – dhjetor 2024) parashikohet një çmim prej 111.88 Euro/MWh për mbulimin e humbjeve, duke rezultuar me një kosto të pritshme rreth 8,248,058 Euro.

Për vitin 2025, humbja e energjisë në rrjet është vlerësuar në rreth 228 GWh. Kjo sasi energjie do të blihet me bazë tregu, duke konsideruar një çmim mesatar vjetor prej rreth 111.8 €/MWh. Fondi që kërkohet për blerjen e kësaj sasive energjie është rreth 25.49 milion euro ose 2,549 milionë lekë.

Për vitin 2026 humbja e energjisë në rrjet është vlerësuar në rreth 234 GWh. Kjo sasi energjie do të blihet me bazë tregu, duke konsideruar një çmim mesatar vjetor prej rreth 101.28 €/MWh. Fondi që kërkohet për blerjen e kësaj sasive energjie është rreth 23.66 milion euro ose 2,366 milionë lekë.

Për vitin 2027 humbja e energjisë në rrjet është vlerësuar në rreth 247 GWh. Kjo sasi energjie do të blihet me bazë tregu, duke konsideruar një çmim mesatar vjetor prej rreth 89.87 €/MWh. Fondi që kërkohet për blerjen e kësaj sasive energjie është rreth 22.22 milion euro ose 2,222 milionë lekë.

6. Në lidhje me parashikimin e kërkesës së energjisë elektrike që pritet të lëvrohet në rrjetin e transmetimit për periudhën 2025-2027, kërkojmë paraqitjen e komunikimeve dhe rakordimeve me përdoruesit e rrjetit të transmetimit (FTL sh.a., OSSH sh.a., FSHU sh.a. si dhe Klientët e Kualifikuar)

Sqarimi: Për sa kërkohet nga ana juaj gjeni bashkëlidhur, komunikimet e vitit 2024 me përdoruesit e SE mbi parashikimet e përcjella mbi konsumin e energjisë dhe prodhimin. Komunikimet kanë qenë nëpërmjet postës elektronike.

7. Nga analizimi i zërit "shërbime ndihmëse" vërehet se kostot faktike të këtij shpenzimi për gjashtë-mujorin e parë të vitit 2024 janë 235 milionë lekë, ndërkohë që kostot ex ante të gjashtë – mujorit të dytë kanë vlerën 806 milionë lekë. Po kështu parashikimet e këtij shpenzimi për vitin 2025 janë përlogaritur 1,759 milionë lekë, për 2026 në vlerën 1,947 milionë lekë si dhe për vitin 2027 në vlerën 2,377 milionë lekë. Duke qenë se, krahasuar me kostot historike për parashikimin e këtij zëri konsiderohet një rritje e ndjeshme, kërkojmë nga ana Juaj paraqitjen e analizave, arsyetimeve si dhe evidencave mbi kapacitetet e përdorura në periudhat e mëparshme krahas kapaciteteve të parashikuara për t'u përdorur në periudhën e propozuar rregullatore të shoqëruara me argumentet dhe shpjegimet përkatëse mbi rritjen e këtij shpenzimi për periudhën e ardhshme rregullatore.

Sqarimi: Për sa i përket parashikimeve të sasive të kapaciteteve për shërbimet ndihmëse ju bëjmë me dije se: Angazhimi i burimeve për të mbajtur frekuencën e rrjetit në nivelin e pranueshëm, organizohet nëpërmjet katër produkteve balancuese FRC,aFRR,mFRR,RR. (shërbime ndihmëse). OST aktualisht prokuron vetëm ($\pm$ aFRR) në rritje dhe në ulje.

Rezervat e Mbajtjes së Frekuencës (FCR), njohur gjithashtu si rezervat e rregullimit primar, nuk prokurohet nga OST sepse asnjë nga OSHB nuk përmbush kushtet teknike për ofrimin e këtij shërbimi. Ndërsa për rezervën zëvendësuese (manuale) mFRR dhe RR nuk është prokuruar sepse kërkesat për balancim deri më tani janë plotësuar nëpërmjet ($\pm$ aFRR).

Rezerva mFRR dhe RR mund të prokurohet në vitet në vijim, në varësi të zhvillimit dhe ndryshimeve që pëson Sistemi i Transmetimit, ajo përcaktohet në funksion të risqeve operacionale që shoqërojnë sigurinë e operimit të sistemit (regjime eksporti apo importi të larta). Parashikohet në atë masë që të mund të sigurojë zbutjen/eliminimin e ndikimit të incidentit duke mos lejuar përhapjen e shqetësimit të krijuar drejt sistemeve fqinje të transmetimit (kriteri i mbulimit të gjeneratorit me fuqi më të madhe i angazhuar në operim).

Rezerva ($\pm$ aFRR) e cila prokurohet dhe ka ndikim në tarifë përlogaritet nga OST në përputhje me Manualin e Operimit të ENTSO-E gjithashtu duke patur në konsideratë vlerat e devijimeve historike. Masa e sigurimit të tyre merr në konsideratë llogaritjet duke përdorur si variabël ngarkesën e vendit në rastin e rezervave automatike të rivendosjes së frekuencës.

Kërkesa e OST mbi sasinë e nevojshme për kapacitetin rezerve, përditësohet çdo vit. Trendi në rritje i rezervave kryesisht diktohet nga rritja e devijimeve në balancën e sistemit si pasojë e integritetit të burimeve të rinovueshme, të cilat kanë luhajtje të konsiderueshme në prodhimin e tyre.

Në vijim tabelat e përcjella nga OST me parashikimet e Kapacitetit Rezerve për shërbimin e balancimit për vitet 2025-2026-2027 (të detajuara në vlera orare)

Viti 2025																									
Ora	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	Σ
aFRR+	29	29	29	29	29	29	29	29	29	29	29	29	29	29	29	29	29	29	29	29	29	29	29	29	697
aFRR-	17	17	17	17	17	17	17	17	17	17	17	17	17	17	17	17	17	17	17	17	17	17	17	17	414
Viti 2026																									
Ora	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	Σ
aFRR+	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30	30	31	31	31	31	31	31	31	31	31	31	31	31	731
aFRR-	18	18	18	18	18	18	18	18	18	18	19	19	18	18	18	18	18	18	18	18	18	18	18	18	434
Viti 2027																									
Ora	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	Σ
aFRR+	32	32	32	32	32	32	32	32	32	32	32	32	32	32	32	32	32	32	32	32	32	32	32	32	768
aFRR-	19	19	19	19	19	19	19	19	19	19	19	19	19	19	19	19	19	19	19	19	19	19	19	19	456

8. Në zërin të ardhura nga tregu i balancimit, sipas tabelës së paraqitur në faqen e katërt, Ju parashikoni që për pjesën e mbetur të vitit të mos gjeneroni të ardhura, ndërkohë që mbështetur në raportimet Tuaja të përcjella me shkresat nr. 6107, datë 04.09.2024 si dhe nr. 6254, datë 12.09.2024 rezulton se OST sh.a. për muajin korrik dhe gusht, ka vijuar të gjenerojë të ardhura nga tregu i balancimit. Gjithashtu, në aplikim për periudhën rregullatore 2025 -2027 nuk janë dhënë shpjegime mbi masat që OST pritët të marrë në lidhje me arritjen e neutralitetit të saj sa i takon të ardhurave nga tregu i balancimit.

Sqarimi: Në lidhje me pikën 8. sqarojmë se OST nuk parashikon të ardhura nga Tregu Balancues, pasi në zbatim të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit çdo Palë Përgjegjëse Balancuese duhet të nominojë programe të balancuara, në këtë mënyrë synimi dhe të gjithë masat që OST ndërmerr është të balancoj Sistemin Elektroenergjetik, si rrjedhojë, OST nuk parashikon në ex-ante të gjenerojë të ardhura nga Tregu i Balancimit, duke synuar një sistem te balancuar.

OST, në cilësinë e operatorit të sistemit, është palë qendrore për qëllim të mekanizmit balancues dhe është përgjegjëse për të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të balancuar sistemin fizikisht dhe të administrojë procesin e llogaritjeve financiare. Si rrjedhojë çdo palë përgjegjëse balancuese deklaron në OST programe të balancuara dhe duke u bazuar në matjet faktike për secilin llogariten disbalancat e shkaktuara.

Në këtë kuadër bazuar dhe në parashikimet e akteve rregullatore në fuqi, OST duhet të sigurojë sasinë e matura për çdo palë përgjegjëse balancuese që aktualisht i siguron me bazë orare njëherë në ditë. Për këtë qëllim, nisur dhe nga kërkesat e vazhdueshme të palëve përgjegjëse balancuese mbi shpeshtësinë e përcjelljes së të dhënave të matjeve në intervale 15 minuta, në mënyrë të tillë që të minimizojnë disbalancat duke bërë update të programeve të tyre për të qenë më afër faktit. Për qëllime të përmirësimit të proceseve të punës dhe automatizim të proceseve është e nevojshme që informacioni mbi të dhënat e matjes së energjisë elektrike, të përftohet më në mënyrë automatike çdo 15 minuta me rezolucion 15 minuta. Kjo mase që po ndërmerret nga OST do jete ndihmuese në uljen e sasive të disbalancave në Sistemin e Elektroenergjetik duke siguruar një sistem të balancuar dhe ne këtë mënyrë do synohet arritja e neutraliteti ne terma financiar te mekanizmit te balancimit.

Ecuria e veprimtarisë dhe aktivitetit të OST sh.a., përditësohet muaj pas muaji për sa i përket Pasqyrave Financiare duke reflektuar pasqyrimin e drejtë në fund të çdo periudhe.

Në këtë kontekst, raportimet periodike i referohen dhe pasqyrojnë gjendjen e llogarive në fund të periudhës së raportimit. Raportimi i bërë për periudhën 6 Muajori i parë 2024, pasqyron në mënyrë të drejtë gjendjen e llogarive në fund të kësaj periudhe. Ecuria e aktivitetit gjatë muajve Korrik – Gusht 2024, reflektohet në gjendjen e llogarive të përditësuara në raportet e pasqyrave financiare për periudhën Janar-Gusht 2024.

9. *Bazuar në konsumin mesatar 10- vjeçar gradienti i konsumit rezulton në një rritje në nivelin 0.29%. Referuar sqarimeve Tuaja në faqen e gjashtë të aplikimit është bërë parashikimi i konsumit të energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit për vitin 2025. i cili ka rezultuar në vlerën 7,525 GWh.*

Ndërkohë, nga faqja numër shtatë e në vijim të aplikimit sasia e parashikuar sipas bilancit energjetik për vitin 2025 evidentohet të jetë 7,400 GWh. Më tej, kjo sasi parashikohet të jetë në rënie për vitin 2026 dhe vitin 2027. Lidhur me sa më sipër, lutemi të kryeni saktësimin Tuaja për sasinë e energjisë që OST sh.a. pret të konsumohet për periudhën e ardhshme rregullatore, si një ndër elementët thelbësor që afekton përlllogaritjen e tarifës së transmetimit. Gjithashtu, lutemi të përcillni argumentet Tuaja mbi parashikimin në rënie të konsumit të energjisë elektrike për periudhat e ardhshme.

Sqarimi: Në lidhje me shqetësimin tuaj të shprehur në pikën 10 të shkresës, sqarojmë se: Duke pranuar që rritja e pritshme e volumit të energjisë elektrike që do të transmetohet nga OST për konsum, të jetë e rendit 0.29%, dhe duke përdorur profilin e ngarkesës me bazë orare për ditën e mesatarizuar të çdo muaji, është bërë parashikimi i konsumit të energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit për vitin 2025 i cili detajohet në tabelën e faqes 6 (gjashtë) të dokumentit të aplikimit. Totali i konsumit bruto për vitin 2025 i cili pritet të jetë rreth 7.5 TWh përfshin edhe humbjet në transmetim.

Detajimet e realizuara në bilancet e energjisë nuk tregojnë konsumin. Bilanci i energjisë detajon hyrjet dhe daljet e flukseve në sistemin e transmetimit për një periudhë të caktuar faturimi.

Në materialin e dërguar dhe në analizën e bërë për përlllogaritjen e tarifës së transmetimit, mbështetur në metodologjinë aktuale, “E-energja totale në kWh që do të tregohet në faturat e klientit të sistemit të transmetimit”, është energjia që pritet të konsumohet për periudhën e ardhshme rregullatore dhe përfshin “Energjinë elektrike për OSHEE Group” dhe “Energjinë elektrike për konsumatorët e kualifikuar”, të cilat të marra sëbashku përbëjnë konsumin si një element thelbësor që afekton përlllogaritjen e tarifës së transmetimit.

Për sa i përket sasisë së konsumit në rënie për vitin 2026 dhe 2027, OST ka marre në konsideratë gjatë vlerësimit dhe integrimin që do të ketë te Parqet Fotovoltaike që pritet të futen në operim si dhe “Vetëprodhues-it” të cilët prodhojnë energji elektrike, e cila konsumohet kryesisht në rrjetin shpërndarës.

Të dhënat mbi sasinë e konsumit në rrjetin e transmetimit, përditësohen çdo vit.

10. Në faqen 10 të aplikimit është paraqitur një tabelë e investimeve që OST sh.a. parashikon të realizojë për periudhën e ardhshme rregullatore, ku për vitin 2025 burimi i financimit të tyre evidentohet në normë 50% me fondet e veta dhe 50% me ndihmë dhe kredi të huaja. Ndërkohë, për vitin 2026 dhe 2027, OST sh.a. pret të realizojë çdo investim me fondet e saj në masën 100%.

Sa më sipër, lutemi të dërgoni analizat e kryera, sqarime si dhe argumentet Tuaja në lidhje me arsyet kryerjes se investimeve vetëm me fondet e vetë shoqërisë, planifikim i cili nuk mbështetet mbi praktikat e ndjekura deri më tani. Gjithashtu, duhet të përfshini përllogaritjet e kryera për koston e ponderuar të kapitalit për secilën alternativë për çdo vit ushtrimor të periudhës rregullatore si dhe efektet e tyre në tarifën e parashikuar për periudhën 2025 - 2027.

Sqarimi: Për sa i përket burimit të financimeve për realizimin e investimeve që OST sh.a. parashikon të realizojë për periudhën e ardhshme rregullatore, nga ana e OST sh.a. janë konsideruar të finalizohen dhe të realizohen gjatë kësaj periudhe, ato investime të cilat kanë angazhime financiare në format e huave të marra, konkretisht realizimi i Projekteve: (i) “Programi i Eficiencës së Energjisë të Sektorit të Transmetimit” - Loti 1: Nënstacionet dhe Loti 2: Linjat” dhe (ii) “Ndërtimi i Linjës së Interkonjeksionit 400 kV Elbasan 2 (Shqipëri) – BITOLA (Maqedoni e Veriut) dhe Elbasan 2 – Fier si dhe Zgjerimi i Nënstacioneve Elbasan 2 dhe Fier”, projekte për të cilët disbursimi i fondeve të angazhuara parashikohet të përfundojnë deri në fund të vitit 2025.

Për vitet në vijim (2026-2027), nga ana e Ost sh.a. nuk ka fonde të huaja të angazhuara për realizimin e investimeve dhe realizimi i projekteve të investimeve të domosdoshme, është parashikuar të realizohet me fondet e OST sh.a.

11. Në shpenzimet operative parashikoni të realizoni shpenzime nga menaxhimi i kongestionit me ridispecerim, shpenzim i cili edhe pse i parashikuar prej jush në periudhën e mëparshme rregullatore nuk është realizuar asnjë rast deri më tani. Lutem sqarimet dhe argumentet tuaja mbi rrethanat se përse parashikoni realizimin e një shpenzimi të tillë në periudhën e ardhshme rregullatore.

Sqarimi: Menaxhimi i kongestionave me ridispecerim, është detyrim për OST prej datës 01.04.2021 me hyrjen në fuqi të Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike. Në zbatim të dispozitave të Kodit të Transmetimit, neni 103 pika 1 germa e, OST sh.a mund ta aplikojë Menaxhimin e kongestionave me ri-dispecerim te energjisë elektrike nga centralet prodhuese në funksion të sigurisë së punës së Sistemit dhe sigurisë së furnizimit, pa ndikuar në detyrimet kontraktore të furnizimit me energji elektrike.

Hyrja në fuqi me Vendimin Nr. 106 /2020 ERE të “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” nuk i lë më hapësira OST ta kërkojë këtë shërbim te përdoruesit e rrjetit, në funksion të sigurisë së punës së Sistemit dhe sigurisë së furnizimit pa shlyer detyrimet financiare për shërbimin e kërkuar nga OST dhe të ofruar nga përdoruesit.

Jo vetëm vendimi 106 i ERE-s por edhe Ligjit 43/2015 (i përditësuar) neni 51, pika 1, germa b) citohen se: Prodhuesit kanë të drejtë: të shesin energjinë elektrike dhe të sigurojnë shërbimet ndihmëse dhe të balancimit në tregun e energjisë elektrike, në përputhje me rregullat e tregut dhe rregulloret e tjera të ERE-s dhe në pikën 2, pika c të nenit 51 citohet se Prodhuesit kanë detyrim: të sigurojnë shërbime ndihmëse ndaj operatorit të sistemit në përputhje me rregullat e tregut.

Me qëllimin e përmbushjes së këtij detyrimi, nga ana e OST sh.a. është kërkuar dhe në periudhat e mëparshme njohja dhe përfshirja e këtyre kostove në tarifën e transmetimit, në mënyrë që të bëhej e mundur siguri i fondeve të nevojshme për kontraktimin e këtij shërbimi, ku e vetmja mundësi për disponibilitetin e fondeve është përfshirja në të ardhurat e kërkuara nëpërmjet tarifës së transmetimit. Deri në këto momente, këto kosto nuk janë njohur/përfshirë në tarifën e transmetimit.

Nga ana e OST sh.a., vlerësohet si e domosdoshme njohja në tarifë e këtyre kosto për të bërë të mundur përmbushjen e këtij detyrimi.

12. *Për bazën e rregulluar të aseteve duhet të dërgohen në ERE të pasqyruara në formë tabelare listat e aseteve me koston e tyre historike (pa përfshirë rivlerësimet), duke evidentuar gjithashtu shtesat përkatëse në çdo grup aset të realizuara gjatë periudhës rregullatore 2022- 2024. Krahas këtyre të dhënave, në këto tabela duhet të përfshihen gjithashtu normat e amortizimit për secilin aset, amortizimi për vitet 2022, 2023 dhe amortizimin e pritshëm për vitin 2024. Në të njëjtën formë kërkohet paraqitja e bazës së rregulluar të aseteve për periudhën 2025 - 2027.*

Në lidhje me planin e investimeve të përcjellë nga ana juaj bashkëlidhur këtij aplikimi, sjellim në vëmendjen Tuaj se bazuar në “Rregulloren për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 135, datë 06.09.2017, neni 11, ERE ka përcaktuar afatet për paraqitjen dhe miratimin e planit të investimeve në kontekstin e aplikimit dhe miratimit të tarifave për veprimtaritë e ushtruara nga operatorët e transmetimit dhe të shpërndarjes në tregun e energjisë elektrike. Këta të fundit do të paraqesin në ERE planin e investimeve për vitin pasardhës në të njëjtën kohë me aplikimin për tarifë.

Në përputhje me sa më sipër, vlerësohet se shoqëria OST sh.a., duhet që të paraqesë për miratim planin e investimeve si një kërkesë më vete nga aplikimi për tarifë e cila duhet të shqyrtohet paralelisht me procesin e përcaktimit të tarifës për periudhën e ardhshme rregullatore mbështetur në përcaktimet e “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve” nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 135, datë 06.09.2017.

Sqarimi: Në tabelat e mëposhtme pasqyrohet informacioni mbi bazën e rregulluar të aseteve, norma dhe amortizimi për çdo grup asetesh, si dhe shtesat e aseteve të kapitalizuara të cilat i përkasin aktivitetit të transmetimit.

Viti 2022							
Nr	Pershkrimi	Llogaria kontabel	% e amortizimit	Kosto historike e aseteve	Amortizimi vjetor	Amortizimi I akumuluar	Vlera neto e aseteve
1	Software dhe licensa	205/208	15%	1,122,873,291	88,730,769	683,794,281	439,079,009
2	Toka	211	0	856,178,783	-	-	856,178,783
3	Punime ne toke	211.5	5%	705,031,575	15,445,338	113,461,452	588,747,712
4	Ndertesa	212	5%	2,889,454,498	93,975,925	1,083,757,908	1,805,696,590
5	Instalime dhe makineri	213	5%	25,584,836,717	849,852,344	10,074,217,555	15,510,619,163
6	Linja	213	5%	24,848,706,102	751,061,228	10,163,702,303	14,685,003,798
7	Paisje, vegla pune	213	20%	2,767,260,973	167,773,807	1,814,367,756	952,893,216
8	Mjete transporti	215	20%	709,503,362	23,799,667	609,085,029	100,418,333
9	Mobileri, pajisje zyre	218.1	20%	201,414,298	9,998,920	102,832,833	98,581,466
10	Pajisje informatike	218.2	25%	1,140,974,733	82,501,541	859,964,979	281,009,754
	Total			60,826,234,333	2,083,139,539	25,508,006,507	35,318,227,825

Viti 2023							
Nr	Pershkrimi	Llogaria kontabel	% e amortizimit	Kosto historike e aseteve	Amortizimi vjetor	Amortizimi I akumuluar	Vlera neto e aseteve
1	Software dhe licensa	205/208	15%	1,193,794,328	85,978,652	769,772,934	424,021,394
2	Toka	211	0	856,178,782	-	-	856,178,782
3	Punime ne toke	211.5	5%	705,031,575	14,673,071	130,956,934	574,074,642
4	Ndertesa	212	5%	2,896,972,026	90,537,015	1,174,294,923	1,722,677,103
5	Instalime dhe makineri	213	5%	25,787,752,815	840,900,016	10,914,410,242	14,873,342,573
6	Linja	213	5%	25,372,603,393	750,900,078	10,914,602,381	14,458,001,012
7	Paisje te tjera, vegla pune	213	20%	2,851,125,102	147,456,415	1,961,820,228	889,304,875
8	Mjete transporti	215	20%	709,883,362	18,995,268	628,115,869	81,767,493
9	Mobileri, pajisje zyre	218.1	20%	207,165,490	9,394,836	112,219,927	94,945,564
10	Pajisje informatike	218.2	25%	1,196,043,606	65,738,319	925,602,774	270,440,831
	Total			61,776,550,481	2,024,573,670	27,531,796,212	34,244,754,269

Viti 2024							
Nr	Pershkrimi	Llogaria kontabel	% e amortizimit	Kosto historike e aseteve	Amortizimi vjetor	Amortizimi I akumuluar	Vlera neto e aseteve
1	Software dhe licensa	205/208	15%	1,193,794,328	85,978,652	855,751,586	338,042,742
2	Toka	211	0	856,178,782	-	-	856,178,782
3	Punime ne toke	211.5	5%	705,031,575	14,673,071	145,630,005	559,401,571
4	Ndertesa	212	5%	2,896,972,026	90,537,015	1,264,831,938	1,632,140,088
5	Instalime dhe makineri	213	5%	28,721,162,854	975,347,976	11,889,758,218	16,831,404,636
6	Linja	213	5%	29,396,005,571	952,070,187	11,866,672,568	17,529,333,002
7	Paisje te tjera, vegla pune	213	20%	2,851,125,102	147,456,415	2,109,276,642	741,848,460
8	Mjete transporti	215	20%	753,483,362	26,988,601	655,104,470	98,378,892
9	Mobileri, pajisje zyre	218.1	20%	207,165,490	9,394,836	121,614,762	85,550,728
10	Pajisje informatike	218.2	25%	1,859,756,505	231,666,544	1,157,269,318	702,487,187
	Total			69,440,675,597	2,534,113,297	30,065,909,509	39,374,766,088

Viti 2025							
Nr	Pershkrimi	Llogaria kontabel	% e amortizimit	Kosto historike e aseteve	Amortizimi vjetor	Amortizimi I akumuluar	Vlera neto e aseteve
1	Software dhe licensa	205/208	15%	1,193,794,328	85,978,652	941,730,239	252,064,089
2	Toka	211	0	856,178,782	-	-	856,178,782
3	Punime ne toke	211.5	5%	705,031,575	14,673,071	160,303,076	544,728,500
4	Ndertesa	212	5%	2,896,972,026	90,537,015	1,355,368,954	1,541,603,073
5	Instalime dhe makineri	213	5%	33,007,148,076	1,007,160,707	12,896,918,925	20,110,229,151
6	Linja	213	5%	33,319,028,740	978,574,242	12,845,246,811	20,473,781,929
7	Paisje te tjera, vegla pune	213	20%	3,189,740,907	154,228,731	2,263,505,373	926,235,533

8	Mjete transporti	215	20%	753,483,362	26,988,601	682,093,072	71,390,290
9	Mobileri, pajisje zyre	218.1	20%	207,165,490	9,394,836	131,009,598	76,155,892
10	Pajisje informatike	218.2	25%	1,940,765,969	242,805,345	1,400,074,663	540,691,306
	Total			78,069,309,255	2,610,341,200	32,676,250,709	45,393,058,546

Nr	Pershkrimi	Llogaria kontabel	% e amortizimit	Viti 2026 Kosto historike e aseteve	Amortizimi vjetor	Amortizimi I akumuluar	Vlera neto e aseteve
1	Software dhe licensa	205/208	15%	1,193,794,328	85,978,652	1,027,708,891	166,085,437
2	Toka	211	0	856,178,782	-	-	856,178,782
3	Punime ne toke	211.5	5%	705,031,575	14,673,071	174,976,147	530,055,429
4	Ndertesa	212	5%	2,896,972,026	90,537,015	1,445,905,969	1,451,066,058
5	Instalime dhe makineri	213	5%	33,580,471,776	1,011,699,519	13,908,618,444	19,671,853,332
6	Linja	213	5%	36,310,935,691	1,038,412,381	13,883,659,192	22,427,276,499
7	Pajisje te tjera, vegla pune	213	20%	3,189,740,907	154,228,731	2,417,734,104	772,006,802
8	Mjete transporti	215	20%	753,483,362	26,988,601	709,081,673	44,401,689
9	Mobileri, pajisje zyre	218.1	20%	239,368,330	10,468,264	141,477,862	97,890,468
10	Pajisje informatike	218.2	25%	2,230,591,521	254,881,410	1,654,956,072	575,635,449
	Total			81,956,568,298	2,687,867,645	35,364,118,354	46,592,449,945

Nr	Pershkrimi	Llogaria kontabel	% e amortizimit	Viti 2027 Kosto historike e aseteve	Amortizimi vjetor	Amortizimi I akumuluar	Vlera neto e aseteve
1	Software dhe licensa	205/208	15%	1,193,794,328	85,978,652	1,113,687,543	80,106,785
2	Toka	211	0	856,178,782	-	-	856,178,782
3	Punime ne toke	211.5	5%	705,031,575	14,673,071	189,649,217	515,382,358
4	Ndertesa	212	5%	2,896,972,026	90,537,015	1,536,442,984	1,360,529,042
5	Instalime dhe makineri	213	5%	33,930,471,776	1,016,074,519	14,924,692,963	19,005,778,812
6	Linja	213	5%	39,276,877,431	1,100,202,834	14,983,862,026	24,293,015,405
7	Pajisje te tjera, vegla pune	213	20%	3,189,740,907	154,228,731	2,571,962,835	617,778,071
8	Mjete transporti	215	20%	753,483,362	26,988,601	736,070,275	17,413,088
9	Mobileri, pajisje zyre	218.1	20%	239,368,330	10,468,264	151,946,125	87,422,204
10	Pajisje informatike	218.2	25%	2,427,600,985	269,757,593	1,924,713,665	502,887,320
	Total			85,469,519,502	2,768,909,281	38,133,027,634	47,336,491,868

Shtesat e aseteve të kapitalizuar në vitet 2022-2027 të cilat i përkasin aktivitetit të transmetimit evidentohen sipas tabelës me poshtë:

Nr	Pershkrimi	Shtesa gjate vitit 2022	Shtesa gjate vitit 2023	Shtesa gjate vitit 2024	Shtesa gjate vitit 2025	Shtesa gjate vitit 2026	Shtesa gjate vitit 2027
1	Software dhe licensa	60,403,843	70,921,037	-	-	-	-
2	Toka	-	-	-	-	-	-
3	Punime ne toke	-	-	-	-	-	-
4	Ndertesa	23,348,206	7,517,528	-	-	-	-
5	Instalime dhe makineri	1,176,812,274	203,713,134	2,933,410,039	4,285,985,221	573,323,700	350,000,000
6	Linja	392,080,313	523,897,292	4,023,402,177	3,923,023,169	2,991,906,951	2,965,941,740
7	Pajisje te tjera, vegla pune	61,331,384	83,864,129	-	338,615,804	-	-
8	Mjete transporti	-	380,000	43,600,000	-	-	-
9	Mobileri, pajisje zyre	36,827,126	5,751,192	-	-	32,202,839	-
10	Pajisje informatike	7,171,324	55,095,424	663,712,899	81,009,464	289,825,553	197,009,464
	Total	1,757,974,471	951,139,737	7,664,125,115	8,628,633,659	3,887,259,043	3,512,951,204

Për sa i përket miratimit të planit të investimeve, si një kërkesë më vete nga aplikimi për tarifë e cila duhet të shqyrtohet paralelisht me procesin e përcaktimit të tarifës për periudhën e ardhshme rregullatore mbështetur në përcaktimet e "Rregullores për procedurat e

paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve” nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 135, datë 06.09.2017, ju bëjmë me dije se nga ana e OST sh.a., do të bëhet një kërkesë më vete në lidhje me këtë çështje.

13. Në lidhje me strukturën e kapitalit (përlllogaritjen e raportit të kapitalit të vetë dhe huave, e cila referuar pasqyrave financiare të vitit 2023 rezulton 70: 30 përqind, duhet të përcillni në ERE të dhënat të shoqëruara me analizat dhe argumentet përkatëse për përlllogaritjen e normës së kthimit në kapital si dhe të kostos së borxhit. Gjithashtu për qëllime të evidentimit të përlllogaritjeve tuaja sa i takon koston së borxhit të realizuar për periudhën rregullatore 2022-2024, lutemi plotësimin dhe paraqitjen e informacioneve sipas formatit si më poshtë:

Sqarimi: Tabelat e detajuara mbi këtë çështje, gjenden bashkëlidhur dhe pjesë e këtij materiali.

Për sa i përket normës së kthimit në kapital, në Metodologjinë e përlllogaritjes së tarifës së transmetimit përcaktohet që “Norma e lejueshme e kthimit mbi kapitalin duhet të vendoset nga rregullatori mbi bazën e nevojës së OST-së për të marrë fluksin e parave për shpenzime kapitale dhe shërbimin e borxhit afatgjatë duke gjykuar nga pasqyra e burimeve dhe perdorimit të fondeve në vitin bazë”. Në aplikimin e bërë nga OST sh.a. për tarifën e nevojshme të transmetimit janë konsideruar: (i) V-1 ku Norma e WACC, e njëjtë me normën e miratuar nga ERE prej 2.28% (AroE =1.8%); (ii) V-2 ku Norma korresponduese e WACC per nivelin e miratuar te tarifës prej 4.81% (AroE =4.75%).

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, jemi në dispozicionin Tuaj për çdo sqarim dhe informacion të nevojshëm.

Me respekt,

ADMINISTRATORI I OST sh.a.
Skëtar Drenova
OPERATORI
I SISTEMIT TE
TRANSMETIMIT